

Date. 28.01 2019.

**AKT-THEMELIMI
SHOQERISE "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS" SHPK**

Me anë të këtij akti, themeluesi i shoqerisë "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS" shpk:

Ortaku i vetem: **Rej Beqiraj**, i biri i Shpëtimit, lindur ne Durrës, me daten 03.01.1993, banues në Tirane ne adresen: Rruga "George W.Bush", Ndërtesa nr.5, Hyrja nr.5, Apartamenti nr.39, Kodi Postar 1017, njesia bashkiakë nr.5, mbajtes i pasaportës Nr.BD5229495, madhor dhe me zotesi të plotë juridike e për të vepruar,

DEKLARON SE:

- 1.** Ka themeluar shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS" shpk.
- 2.** Aktiviteti i shoqerise "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS" shpk, do të organizohet dhe funksionojë mbi bazën e diapositave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, si dhe në përputhje me ligjin nr.55/2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë".
- 3.** Ky Akt-themelimi dhe Statuti bashkalidhur janë pregetitur konformë kerkesave te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar.
- 4.** Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është fiksuar për një periudhe kohe të pakufizuar.
- 5.** Selia e shoqerisë është në adresen: Rruga "Urani Pano", Ndërtesa nr.5, Hyrja nr.7/3, Apartamenti nr.6, Kodi Postar 1016, Njesia Bashkiakë Nr.9 - Tiranë.
- 6.** Shoqeria do ushtroje aktivitetin e saj tregtar si studio avokatë duke ofruar keto sherbime:
 - a.** këshillim ligjor i personave fizikë dhe juridikë;
 - b.** përfaqësim në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjeter që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjeter, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit;
 - c.** hartimi i akteve juridike dhe te çdo akti tjeter, sipas kërkesave të personave fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - d.** veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 7.** Për përbushjen e objektit te veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt veprimtarie të njëjtë ose të ngjashëm me të sajët dhe mund të kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e te paluajtshëm.



8. Shoqeria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lekë apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke disponuar lirisht mjetet monetare të akumuluara në to, konform legjislacionit në fuqi.

9. Kapitali themeltar i shoqerisë përbëhet vetëm nga kontribute në para dhe është 100.000 (njëqind mijë) Lekë. Kapitali themeltar përbehet nga 1 (një) kuote e vetme me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë, e cila zotërohet tërëresisht nga ortaku i vetëm i shoqerisë **Z. Rej Beqiraj**.

10. Sipas vendimit të ortakut në këtë akt themelimi dhe statut, detyra e administratorit i besohet **Z. Artur Prenga**, i biri Gjergjit, lindur në Vau Dejës – Shkodër, me datë 27.09.1992, banues në adresen: Rruga "Vorpsi" (ish rruga "Sulejman Pasha"), banesë private me nr.64, kati parë, hyrja 2, Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me nr. J20927044D. Administratori është emeruar për periudhe 5-vjeçare, me të drejte ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

11. Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Në përfundim të vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, Asambleja pasi ka ndarë fondet për likuidimin e detyrimeve ndaj të treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos për ndarjen e fitimit neto. Për humbjet përgjigjet eskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj. Fitimi i realizuar mund të transferohet lirish jashtë Shqipërisë, konformë legjislacionit në fuqi.

12. Ortaku mund ta zmadhojne kapitalin e tij në shoqëri, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerisë, konformë parashikimeve ligjore dhe statutare.

13. Ortaku dhe Administratori janë të detyruar të ruajnë sekretin mbi dokumentacionin dhe të dhenat, njojurite dhe eksperiencat e fituara gjatë aktivitetit të shoqerisë, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të evituar përhapjen, qoftë edhe pjesërisht. Ata janë përgjegjës për pasojat negative që mund të vijnë nga shkelja e detyrimit të mesiperme.

14. Për sa nuk specifikohet shprehimisht në këtë akt themelimi, vlejnë normat e Statutit të "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS" shpk dhe legjislacionit ne fuqi.

Paralelisht me nënshkrimin e këtij akti, ortaku i vetëm ka nënshkruar edhe Statutin e shoqerisë "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS" shpk, i cili i bashkëlidhet aktit të themelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

"ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "STUDIO LIGJORE BEQIRAJ & PARTNERS"
SHPK

(Av. Rej Beqiraj)